



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3510/6 prot.

Datë 16.12.2024

V E N D I M

Nr.1783 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-25717-10-21-2024, me objekt: “Blerje pelet”, me fond limit 4,927,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alcani” SHPK me NIPT J91505006Q dhe adresë: Blloku Frutikulturë, rruga e Laknasit, 100 m pranë urës.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë: Tiranë, Vaqarr, Rruga Arbanë, Vaqarr, me zonë kadastrale 3712, nr.pasurie 19/18

Operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK me NIPT L23109601T dhe adresë: Gjirokastër, Goranxi Gjirokastër 6001

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.10.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-25717-10-21-2024, me objekt: “Blerje pelet”, me fond limit 4,927,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 01.11.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Fatjon Alcani p.f	3,283,000 lekë	skualifikuar
“ALBA PALLETS & PELLET” SHPK	3.577.777 lekë	skualifikuar
“SULLOLLARI-KLIMA” SHPK	3.695.250 lekë	kualifikuar
“WOODPECKER” SHPK	3.705.000 lekë	kualifikuar
“ALCANI” SHPK	4.082.000 lekë	kualifikuar
Aleksandër Coli p.f	4,532,840 lekë	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik me datë 21.11.2024, rezulton se është publikuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 27.11.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4845 dhe me nr.3510 prot., datë 02.12.2024 e operatorit ekonomik “Alcani” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Sulollari-Klima” SHPK, dhe “Woodpecker” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3510/2 prot., datë 02.12.2024.

II.7. Me shkresën nr. 10274/1 prot., datë 05.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3510/3 prot., datë 10.12.2024 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alcani” SHPK, konkretisht vendimi i KSHA me nr. 10274 prot., datë 05.12.2024 lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës konkretisht duke argumentuar: “[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh me ankesën e operatorit ekonomik “Alcani” SHPK konstaton se nuk është dhënë asnjë provë se ku mbështet pretendimet e tij si dhe të justifikojë interesin e tij të ligjshëm. Referuar sa më

sipër Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vlerëson se; Ankesa e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mbështetur në nenin 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

VENDOSI:

Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alcani’ SHPK.”

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alcani ” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Woodpecker” SHPK me pretendimin se: *“Vërejmë se është kualifikuar dhe Operatori Ekonomik WOODPECKER. Ditën e dorëzimit të mostrës pranë AK Bashkia Kamëz është konstatuar nga Përfaqësuesi i ALCANI SHPK se Operatori Ekonomik WOODPECKER ka dorëzuar një mostër peleti pa tregues në Fletë Analize se ky produkt ka në përbërje llojin e drurit Ahun dhe Bredhin. Ashtu si Operatori Ekonomik SULOLLARI-KLIMA, i cili është kualifikuar me mungesë dokumentacioni dhe me mall objekt prokurimi jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST, është kualifikuar dhe Operatori Ekonomik WOODPECKER me mall objekt prokurimi jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST. KVO Bashkia Kamëz duhet të verifikonte produktet e ofruara nga Operatoret Ekonomik të interesuar dhe jo të kualifikojë e skualifikojë me dy standarde. Që malli objekt prokurimi i ofruar të jetë i njëjte me mallin objekt prokurimi të kërkuar në DST, duhet që operatorët ekonomik të ketë të pasqyruar në Fletë-Analizën e Peletit Llojin e Peletit dhe Përbërjen e tij. Në DST është kërkuar Pelet druri AHU 85 % + BREDH 15 %, sic do ta gjeni dhe tek Fletë-Analiza e Operatorit Ekonomik ALCANI SHPK, që ne kemi ngarkuar ne SPE. Operatori Ekonomik WOODPECKER sipas verifikimeve tona dhe ne web nuk ka askund të reklamuar përbërjen dhe materialin drusor të përdorur siç kërkohet në DST. Këto elemente na bëjnë të kemi dyshimin e arsyeshem se ky OE nuk e disponon mallin e kërkuar sipas DST, pra Pelet druri AHU 85% + BREDH 15%, të cilën mund ta verifikoni lehtësisht në Fletë-Analizën e ngarkuar nga OE WOODPECKER në SPE. Kërkojmë verifikimin nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Bashkia Kamëz dhe Komisioni Prokurimit Publik të 3 (tre) Flete Analizave të mallit objekt prokurimi PELET të ngarkuar në SPE, përkatësisht të Operatorit Ekonomik ALCANI SHPK, të Operatorit Ekonomik SULOLLARI-KLIMA dhe Operatorit Ekonomik WOODPECKER, sipas specifikimeve teknike të kërkuar në DST.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.4. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në mënyrë elektronike në sistem, fletë-analizën nga Laboratori i certifikuar të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organ ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara për vlerësimin e mostrës së mallit objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Dëshmia dhe rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar deri në 3-muaj para datës së zhvillimit të tenderit. (Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit të laboratorit të kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës, ose në se kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor).*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” është përcaktuar si më poshtë:

SPECIFIKIME TEKNIKE

Pelet

- *Lënda djegëse duhet të plotësojë kërkesat e standardeve shtetërore për këtë produkt*
- *Karakteristikat teknike për pelet lloji drurit AH 85% + 15% bredh (vetëm tallash, jo lëvozhga druri)*
- *Standardi i cilësisë A1 15KG*
- *Vlera Kalorike > 5.0 këh /kg (18.0 MJ /KG)*
- *Diametri 6 +1 mm*
- *Përmbajtja e lagështisë < 8%*
- *Përmbajtja e pluhurit <1%*
- *Përmbajtja e hirit <0.5%*
- *Densitetit < 670 kg/m³*
- *Qëndrueshmëria <97.5*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Raport testimi me nr. 1493/24 datë 24.10.2024 lëshuar nga korporata “Sara & Meti” SHPK me përmbajtje si vijon:

RAPORT TESTIMI

Nr. 1493/24

Laboratori Analitik, Bujqësorë dhe i Ushqimit

- | | |
|---------------------------|--|
| 1. Mostra për analizë | Mostër e Peletit të drurit |
| 2. Analizat e kërkuara | Analizat fiziko-kimike (analizat e kualitetit) |
| 3. Porositësi i analizave | Ndoc Deda. WOODPACKER Shkodër. Shqipëri |
| 4. Marrja e mostrës | Mostra është sjellë në laborator nga pala |

Rezultatet e analizave:

Parametri i analizuar	Njësia matëse	Vlerat referente	Rezultatet e futuara	Klasifikimi sipas standardit	Metoda e zbatuar
Diametri	[mm]	6 (+1) apo 8 (+1) mm	6.08	D0.6	*EN 14961-2
Gjatësia	[mm]	3,15 < L < 40 mm	25.16	D0.6	*EN 14961-2
Densiteti	[kg/dm ³]	> 600 kg/m ³	678	DB650	*EN 14961-2
Qëndrueshmëria	[%]	> 97.5	98.92	DU 97.5	*prEN 15210-1
Lagështia	[%]	< 10 w-% wet basis	4.61	M10	ISO 712:1998
Vlera kalorifike	[MJ/Kg]	16.5 ≤ Q ≤ 19	18.37	> 16.5	EN 14961-2
Hiri	[%]	< 0.57 w-% dry	0.56	A0.7	ISO 5984:1978
Përmbajtja e pluhurit	[%]	< 1.0 w-% dry	0.38	A1.0	EN 14961-1
Sulfuri	[%]	< 0.05 w-% dry	0.03	S0.05	EPA metoda 375.3
Klori	[%]	< 0.03 w-% dry	0.02	Cl0.02	EPA METODA 325.3
Azoti	[%]	< 1.0 w-% dry	0.25	N0.3	ISO 5983:1997
Pb	[mg/kg]	< 10.0 mg/kg dry	< 0.01	N/A	ISO 6869:2000
Cd	[mg/kg]	< 0.5 mg/kg dry	< 0.001	N/A	ISO 6869:2000

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

- Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose të ofrimit të punëve, të furnizimeve ose të shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionalë me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet, edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose të projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshirë në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/i saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzoj një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.7. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.8. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.”.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të, cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në rastin konkret referuar pretendimeve të ankimesit “Alcani” SHPK dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike për mallin objekt prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.3 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e ankimesit “Alcani” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Woodpecker” SHPK, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, ky i fundit nuk i ka përmbushur specifikimet teknik konkretisht për pikën *Karakteristikat teknike për pelet lloji drurit AH 85% + 15% bredh (vetëm tallash, jo lëvozhga druri)*. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik e konkretisht raportit të testimi nr. 1493/24 datë 4.10.2024 lëshuar nga korporata “Sara & Meti” SHPK, KPP vëren, se përmbajtja e tij nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, pasi nuk ka në asnjë pikë të përmbajtjes së tij specifikimin teknik *pelet lloji drurit AH 85% + 15% bredh (vetëm tallash, jo lëvozhga druri)*. Referuar specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, peleti duhet të ketë llojin e drurit AH 85% + 15% bredh, ndërsa në raportin e testimi të sipërcituar nuk jepet asnjë informacion mbi llojin e drurit të peletit duke rënë në kundërshtim me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor për mallin objekt prokurimi. Sipas këtij konstatimi, raporti i testimi i paraqitur nga operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK për përmbushjen e specifikimeve teknike konkretisht për lloji e drurit AH 85% + 15% bredh nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi ky raport testimi nuk jep asnjë informacion për llojin e drurit të peletit AH 85% + 15% bredh sipas specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor të cituara më sipër. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertat e tyre në përputhje me kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoritetet kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi në të kundërt ato refuzohen si oferta të pasuksesshme. Referuar sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK me raportin e testimi të paraqitur në sistem nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit lidhur me *pelet lloji drurit AH 85% + 15% bredh (vetëm tallash, jo lëvozhga druri)*.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “Alcani” qëndron.

III.1.11. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Woodpecker” SHPK do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alcani” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK me pretendimin se “nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit duke u shprehur se: “Lejet Mjedisore që disponon secili Operator Ekonomik janë të pasqyruara në sistemin elektronik të QKB. Vërehet që Operatori Ekonomik SULOLLARI-KLIMA disponon, vetëm Leje Mjedisore të Tipit C, e cila nuk është në përputhje dhe nuk përmbush pikën 2.3.9 të DST.” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.9 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet të jete i pajisur Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) Veprimtaritë e lëndës drurit dhe produkteve të përbëra siç është pelleti së bashku me akt miratimin përkatës, e cila lidhet me objektin e prokurimit.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të kategorisë III.2.B Grumbullim, transportim, përpunim i mbetjeve të lëndës drusore si dhe liçensën profesionale përkatëse.

III.2.2. Në përmushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ka dorëzuar:

- Autorizim të datës 03.06.2024 të shoqërisë “Eco Energy Pellets”, sipas të cilit kjo e fundit shprehet se autorizon shoqërinë Sulollari-Klima me NIPT K0152900M me adresë RR. “Muhamet Gjollësja” 71/ Kati I. Tiranë të paraqesë oferta dhe rrjedhimisht të nënshkruajë kontrata me subjekte të ndryshme në Shqipëri dhe të tregtojë peletin e ofruar prej tyre. Me anë të këtij autorizimi japin garancinë në përputhje me kushtet e

përgjithshme të kontratave nga mallrat e ofruara nga “Sulollari Klima” shpk për furnizimin dhe tregtimin e paletit.

- Kontate furnizimi me nr. Rep 11534 dhe nr. 7730 Kol e datës 18.10.2023 lidhur mes shitësit (furnizuesi) shoqëria “Eco Energy System” SHPK dhe blerës (pranues i furnizimi) shoqëria “Sulollari Klima” shpk me afat të pacaktuar dhe me objekt: “Furnizimi nëpërmejt shitjes nga furnizuesi tek pranuesi (blerësi) të lendeve djegese “Pelete” bashkëlidhur së cilës gjenden:
- Leje mjedisore e subjektit “Eco Energy System” me Kod III.1.B dhe nr. PN-6395-11-2013.
- Akt miratim leje mjedisore tipi B me nr. 8040 prot., datë 11.11.2013 me nr. identifikues 1484 për subjektin Eco Energy System shpk.
- Licence me numer LN-2503-01-2017 për subjektin “Eco Energy System” e datës 11.01.2017 me Kod III.2.B.
- Akt miratim licence e kategorisë III.2.B me nr. 170 prot., datë 11.01.2017 dhe nr. identifikimi 222 per subjektin “Eco Energy System” shpk.

III.2.3. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” nuk ka bërë asnjë deklaram mbi subjektet në kapacitetin e të cilëve do të mbështetet, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• Informacione për nënkontraktorin

Emri nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

III.2.4. Ne nenin 14 “Operatorët ekonomik” të nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktorë mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.2.5. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriteret e veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Europian.”

III.2.6. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.7. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.9. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit që operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHKP nuk disponon lejet e kërkuara në pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga “Sulollari Klima” SHPK rezultoi se ky i fundit nuk e ka përmbushur kriterin e kërkuar në pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistem së pari vihet re se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ka ofertuar i vetëm dhe jo si bashkim operatorësh ekonomikë në kuptim të nenit 14 të *lex specialis*. Gjithashtu referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistem rezultoi se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK nuk është as në

kushtet e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera në kuptim të asaj cfarë legjislacioni i prokurimit publik përcakton në lidhje me këtë fakt sepse ai në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, konkretisht pika B, seksioni *“Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* nuk ka dhënë informacion për subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar është përcaktuar qartë se: *“2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;”* Fakti që operatori ekonomik *“Sulollari Klima” SHPK* nuk ka deklaruar në dokumentet e ofertës konkretisht në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet si dhe nuk paraqitet as në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi do të thotë që leje e kërkuar nga pika 2.3.9 e kriterëve të veçanta të kualifikimit duhet të paraqiteshin në emrin e vetë ofertuesit *“Sulollari Klima” SHPK* dhe jo leje të subjektit *“Eco Energy Sistem” SHPK* me të cilin referuar dokumenteve të ofertës ai nuk paraqitet as në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe as si subjekt mbi të cilin do të mbështetet në këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuadër KPP gjykon se leja me Kod III.1.B dhe nr. PN-6395-11-2013; Akt miratim leje mjedisore tipi B me nr. 8040 prot., datë 11.11.2013 me nr. identifikues 1484; Licence me numer LN-2503-01-2017 e dates 11.01.2017 me Kod III.2.B si dhe Akt miratim licence e kategorise III.2.B të subjektit *“Eco Energy System” SHPK* të dorëzuara në sistem nuk mund të koniderohet që e përbushin kërkesën e pikës 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi për sa kohë *“Sulollari Klima” SHPK* nuk shfaqet me shoqërinë *“Eco Energy System” SHPK* as në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe as si subjekt mbi të cilin mbështetet, këto leje dhe licenca të kërkuara në kriterin më sipër duhet të paraqiteshin në emrin e vetë operatorit ekonomik *“Sulollari Klima”* dhe jo të subjektit *“Eco Energy System” shpk*. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 *“Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”*, të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.* Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo shikohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik jo vetëm janë përcaktuar kriteret për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera por duhet edhe të deklarohet kjo mbështetje në dokumentet e ofertës. Autorizimi i lëshuar nga *“Eco Energy System” shpk* si dhe kontrata e furnizimit të tij me *“Sulollari Klima” SHPK* nuk përbëjnë një angazhim me shkrim në kuptim

të pikës 3 të nenit 84 të *lex specialis* pasi ai nuk është deklaruar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbështetës i “Sulollari Klima” SHPK. Në këtë kuadër KPP gjykon se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.9 të kriteve të veçanta të kualifikimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit kpnkretisht pika 2.3.9 e kriteve të veçanta të kualifikimit, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “Alcani” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ankimuesit për kualifikimin e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ato nuk do të merren në shqyrtim për shkak të ekonomisë në procesin administrativ pasi referuar arsytimit më sipër të KPP gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar e si rrjedhojë duke përmbushur edhe interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alcani” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-25717-10-21-2024, me objekt: “Blerje pelet”, me fond limit 4,927,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamez
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Woodpacker” SHPK dhe “Sulollari-Klima” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këto operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alcani” SHPK .
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

